



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Shkurt 2022

Nr: 78

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “SHKODRA WEB”, “ALBANIAN POST”, TV “ORA NEWS”, AGJENCISË “LIGHT STUDIO AGENCY”, TV “VIZION PLUS”, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022

Sot, më datë 16.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

KËRKUES:

1. “Shkodra Web”, me seli në Shkodër, rruga “Marin Becikemi”, me përfaqësues z. Blerti Delija;
2. “Albanian Post”, me seli në Tiranë, rruga “Dervish Hima”, me përfaqësuese zj. Gerta Zaimi;
3. “Ora News”, me seli në Tiranë, rruga “Aleksandër Moisiu”, ish Kinostudio, me përfaqësues z. Brahim Shima;
4. “Light Studio Agency”, me seli në Tiranë, me përfaqësues z. Gentian Shkullaku;
5. “Vizion Plus”, me seli në Tiranë, rruga “Don Bosco”, nr. 5, me përfaqësues z. Arban Hasani.

OBJEKT:

Kërkohet akreditimi si vëzhgues i gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE:

Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit



të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,

VËREN:

“Shkodra Web” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 5, të nenin 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. “Shkodra Web” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor.

“Albanian Post” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 11 (njëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor. “Albanian Post” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor.

“Ora News” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor. “Ora News” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor.

“Light Studio Agency” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 5 (pesë) përfaqësuesve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor. “Light Studio Agency” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor.

“Vizion Plus” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 80 (tetëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 6, të Kodit



Zgjedhor. “Vizion Plus” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 6, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 4 (katër) gazetarëve dhe operatorëve të Medias “Shkodra Web”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 11 (njëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të Mediumit Online “Albanian Post”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) gazetarëve dhe operatorëve të TV “Ora News”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 5 (pesë) përfaqësuesve të Agjencisë “Light Studio Agency”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 80 (tetëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të TV “Vizion Plus”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 16 Shkurt 2022
Nr. 78

“Për shqyrtimin e kërkesës së “Shkodra Web”, “Albanian Post”, TV “Ora News”, agjencisë “Light Studio Agency”, TV “Vizion Plus”, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”